

## ABSTRAKT

Qëllimi i punimit është që të analizohen faktorët që ndikojnë në zhvillimin ekonomik në kushtet dhe rrethanat e Kosovës. Në këtë drejtim janë prezantuar aspekte teorike të faktorëve në zhvillimin e bizneseve, ku hulumtimet e shumta teorike dhe praktike kanë dokumentuar se ekziston një lidhje pozitive në mes tatimeve dhe bizneseve. Është analizuar ndikimi i legjislacionit tatimor i cili do të ketë efekte në zhvillimin e biznesit. Politika fiskale paraqet njërin nga komponentet më të rëndësishme të politikës ekonomike dhe si e tillë ajo duhet të trajtohet në kontekst të saj. Për këtë ekzistojnë së paku dy arsye: E para, politika ekonomike i përcakton qëllimet dhe kriteret e politikës fiskale me qëllim të vlerësimit të kontributit të saj në realizimin e politikave ekonomike dhe e dyta, duke përcaktuar lidhmërinë në mes të qëllimeve dhe instrumenteve, teoria e politikës ekonomike e sqaron procesin e realizimit të qëllimeve të politikës ekonomike pjesë e të cilit proces është edhe vetë politika fiskale. Për këtë arsye në vazhdim në mënyrë mjaft të drejtpërdrejt do të trajtojmë ndërvarshmërinë në mes të politikës ekonomike dhe të politikës fiskale.

MENTOR:

PROF. BEDRI PEÇI

STUDENTE:

ADELINA OSMANI